



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
DREJTORIA E TARIFAVE DHE ÇMIMEVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ .04.2026

RELACION

MBI

**TARIFAT E SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
PERIUDHËN 1 MAJ 2026 – 31 DHJETOR 2026**

Në mbështetje të nenit 19, gërma “c”, pika “i”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ERE miraton dhe publikon, në përputhje me parimin e transparencës dhe duke marrë në konsideratë koston e shërbimit të ofruar, tarifat për shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 312, datë 12.12.2025 vendosi lënien në fuqi deri më 30 Prill 2026 të tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022, duke konsideruar nder tjera:

-ERE me vendimin e bordit nr. 308, datë 21.11.2025, vendosi mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e planit 5-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarje.

-Shoqëria OSSH sh.a. brenda katër - mujorit të parë të vitit 2026, duhet të depozitonte në ERE pasqyrat financiare të audituara për periudhën ushtrimore 2024”, dhe treguesit tekniko ekonomik sa i takon parashikimit për vitin 2026 si dhe cdo informacion të nevojshme mbi realizimin e treguesve tekniko-ekonomik dhe financiar për periudhat e mbyllura ushtrimore 2022 -2025.

ERE ka kryer vlerësime të përvitshme në lidhje me mjaftueshmërinë e të ardhurave të kërkuara të realizuara nga tarifat në fuqi. Per qellime te kesaj analize jane marre ne kosnderate Pasqyrat Financiare të audituara për vitet 2022 dhe 2023 (sic evidentuar ne Vendimin 312/2025)

Po ashtu u analizua informacioni lidhur me pasqyrat e audituara për vitin ushtrimor 2024, pasqyrat financiare paraprake për vitin 2025, parashikimin e pasqyrave financiare për vitin 2026 si dhe bilancin energjetik percjelle ne ERE nga OSSHE në kuadër të detyrave të lëna në vendimin e bordit nr. 312/2025, si dhe shkresat e OSSHE me nr 2958/1 prot., datë 10.12.2025, nr. 310 prot.,

datë 23.01.2026 dhe 349 prot., datë 26.01.2026 sh.a të përcjella nga shoqëria në kuadër të kërkesave të ERE.

Në vijim, vlerësimi i kryer mbi të ardhurat e kërkuara të realizuara dhe atyre të parashikuara është mbështetur në parimet rregullatore të përcaktuara në zbatim të “*Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike*” (miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017) si dhe parimet dhe rregullat për përcaktimin e tarifave të përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, i ndryshuar, duke vlerësuar të dhënat e evidentuara në informacionet teknike, ekonomike dhe financiare të përcjella nga shoqëria OSSH sh.a me korrespondencat e sipërcituara.

Bordi i ERE në vendimin nr. 73, datë 13.04.2022 mbështetur në vlerësimet dhe arsyetimet e këtij vendimi si dhe bazuar në tarifën mesatare të shërbimit të shpërndarjes prej 5.89 lekë/kWh përcaktoi ndër të tjera, tarifat e shërbimit të shpërndarjes për nivele tensioni si më poshtë:

- Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV - 1.55 Lekë/kWh;
- Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.6 - 20 kV - 3.99 Lekë/kWh ;
- Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV - 6.42 Lekë/kWh .

Gjatë procesit të kryerjes së këtyre përlllogaritjeve, u morën në konsideratë nivelet e rishikuara të humbjeve sipas VKM nr. 758, datë 09.12.2021, “*Për një ndryshim në vendimin nr. 253 datë 2404.2019, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik*”. Si të tillë ERE rishikoi kostot e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve sipas nivelit të lejuar mbështetur në VKM sipërcituar për periudhën 2015–2021, ku nga ky rivlerësim rezultoi një vlerë totale kostosh prej 24.6 miliard lekë. Duke qenë se një pjesë e këtyre kostove mbulohej nga të ardhurat shtesë të realizuara nga shoqëria gjatë periudhës 2015–2021 (rreth 18 miliard lekë), mbetej një diferencë prej rreth 6.18 miliard lekë e pa rikuperuar vlerë kjo e rishikuar për qëllime të vlerësimit të periudhës aktuale (2026) mbështetur në pasqyrat financiare të audituara të vitit 2021. Vlera e rishikuar bazuar në të dhënat faktike për vitin 2021 rezultoi 6.21 miliard lekë e cila vlerësohet të korrigohet/kompensohet si diferencë e vlerës 6.18 miliard lekë dhe realizimit 6.21 miliard lekë në kuadër të tarifave për vitin 2026, sic evidentohet dhe në tabelën në të cilën evidentohen kostot faktike dhe të parashikuara të shoqërisë për periudhën objekt të këtij vlerësimi më poshtë në këtë relacion.

Sikurse evidentuar në konstatimet e vendimit nr.73/2022, nga përlllogaritja e kostove të aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, tarifa mesatare e shpërndarjes e llogaritur për periudhën 1

Janar – 31 Dhjetor 2022, rezultonte në nivelin 5.62 lekë/kWh. Meqënëse tarifat e reja do të aplikoheshin për periudhën 1 Maj – 31 Dhjetor 2022, diferenca e korigjueshme për periudhën 1 Janar - 30 Prill 2022 (rreth 1.5 miliard lekë), u reflektua në një tarifë mesatare të shpërndarjes të ndryshme për periudhën e mbetur të vitit 2022, me qëllim rekuperimin e të ardhurave të pafaturuara në 4 mujorin e parë të vitit të cilat do të korigjoheshin në zbritje në periudhën pasardhëse rregullatore.

Nga vlerësimet e kryera gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimit në fjalë, rezultonte se nëse në përlllogaritjet e kryera nuk do të konsideroheshin fitimet e munguara të 4 mujorit të parë të vitit 2022 si dhe kostot e parikuperuara të humbjeve sipas VKM 758/2021, tarifa mesatare e shpërndarjes do të ishte në nivelin 5.08 lekë/kWh.

Ne kuptim të sa më sipër tarifat mesatare për qëllime të korgjimit të të ardhurave të kërkuara ndaj atyre të realizuara për vitet 2022, 2023, 2024 - 2025 janë respektivisht: 5,89 lekë/kWh, 5.62 lekë/kWh, dhe 5.08 lekë/kWh sikurse evidentuar edhe tabelen më poshtë të korigjimit të të ardhurave të kërkuara.

Analiza dhe vlerësimi i të ardhurave të kërkuara

Në përputhje me përcaktimet e “Metodologjisë së përlllogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017, në vijim u krye analiza dhe vlerësimet mbështetur në të dhënat e pasqyrave financiare të audituara të viteve 2022 – 2024, pasqyrave paraprake të vitit 2025 si dhe parashikimeve të shoqërisë për vitin 2026.

Ky vlerësim nuk përbën një proces të plotë të përcaktimit të tarifave, por një analizë të mjaftueshmërisë së të ardhurave të kërkuara të vitit 2026, bazuar në të dhënat e sipërcituara. Vlerësimi i komponentëve të përlllogaritjes së tarifës konsiston në reflektimin e kostove faktike dhe të përditësuara, në përputhje me parimet e transparencës dhe të një tarife kosto-reflektuese, sipas përcaktimeve të metodologjisë në fuqi. Në këto kushte, analiza e kryer shërben si bazë orientuese për vendimmarrjen aktuale, pa zëvendësuar nevojën për një rishikim të plotë tarifor për periudhën pasardhëse. Në këtë kuadër, kjo analizë merr në vlerësim aftësinë e shoqërisë për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe vijueshmërinë e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, nivelin e të ardhurave të kërkuara të realizuara dhe të parashikuara për periudhën në shqyrtim, si element thelbësor për përcaktimin e tarifave në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë së sistemit.

Referuar Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike komponentet e përlllogaritjes së të ardhurave të kërkuara janë si vijon:

Kostot Operative (OPEX)

Referuar krahasimit të vlerave ex-ante të kostove operative totale, të pranuar nga ERE për vitin 2022 me vlerat ex-post të kostove operative totale të realizuara, konstatojmë se realizimi i tyre është rreth 4% më i ulët se pranimet e kryera për vitin 2022. Gjatë vitit 2023, realizimi i këtyre zërave ka vijuar të shfaqë qëndrueshmëri (0.9 % rritje). Ndërkohë që në vitin 2024 këto shpenzime kanë pësuar një rritje me rreth 7 %, krahasuar me vitin 2023. Nga informacionet e përcjella evidentohet se për periudhën në shqyrtim kostot operative do vijojnë të ruajnë të njëjtin trend.

Gjithashtu në analizë është marrë edhe informacioni i përcjellë nga shoqëria me e-mailin e datës 09.04.2026, në pergjigje të kërkesës se ERE date 03.06.2026 (per qëllime të përditësimit të informacionit mbi luhatjet e OPEX për vitin 2024 kundrejt vitit 2023, zërit “shpenzime materiale dhe konsumi” të vitit 2024 krahasuar me vitin 2025 dhe grup shpenzimeve “Qira” nga krahasimi i periudhës kontabël 2024 me 2025, ku ndër të tjera shoqëria sqaroi si më poshtë:

“Rritja e shpenzimeve për paga të punonjësve që u aprovua në fund të vitit 2023 ishte shkaku kryesor për rritjen e shpenzimeve të vitit 2024 në krahasim me vitin 2023;

Vlera prej 591 milion lekë (2024 për zërin “shpenzime materiale dhe konsumi”) i referohet shpenzimeve në tabelën e Pasqyrave Financiare

Shpenzime e përfshira në vlerat e ulëta prej 290 milion lekë për vitin 2025 dhe 277 milion lekë për vitin 2026, përfshijnë vetëm shpenzime për lëndë djegëse, kancelari dhe materiale të tjera (kryesisht vegla pune dhe veshëmbathje për punonjësit).

Shpenzime “Qira” prej 160 milion lekë të planifikuara përmbajnë vlerën e shpenzimeve pjesa më e madhe e të cilave janë qira financiare, të cilat në fund të vitit (për shkak të procedurave të kontabilizimit) do të pasqyrohen si pjesë e shpenzimeve të amortizimit.

Zërat që zënë peshën kryesore të kostove operative janë “shpenzimet e personelit” si dhe “kosto e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve”. Kosto për mbulimin e humbjeve përfshijnë zërat “Kosto e transmetimit për humbjet”, “Kosto e humbjeve Totale” dhe “Disbalancat”. Në analizën e kryer niveli i humbjeve të energjisë në rrjetin e shpërndarjes nuk ka tejkaluar nivelin e lejuar të humbjeve, të përcaktuar sipas VKM nr. 758, datë 09.12.2021, “Për një ndryshim në vendimin nr. 253 datë 2404.2019, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik” të cilat pasqyrohen në tabelën më poshtë:

HUMBJE		
VITI	Target sipas VKM nr. 759/2023	Realizimi Raportet Vjetore ERE
2021	20.5%	20.62%
2022	19.6%	19.70%
2023	19.0%	18.93%
2024	18.5%	17.93%
2025	18.1%	16.96%
2026	17.8%	

Vlerat e realizuara të kostove të blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve kanë qënë brenda nivelit të lejuar të humbjeve të përcaktuara sa më sipër. Gjithashtu edhe për vitin 2026 shoqëria OSSH sh.a. ka parashikuar të ruajë të njëjtin trend për realizimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes sipas nivelit të lejuar në VKM nr.758/2021.

Kostot e kapitalit (CAPEX)

Baza e Rregulluar e Aseteve

Në pranimet e kryera për vitin 2022 baza e rregulluar e asetëve të shoqërisë OSSH sh.a. pas zbritjes së amortizimit të akumuluar, ka qënë në vlerën rreth 30 miliardë lekë mbështetur në koston historike të njohur nga ERE sipas vendimarrjeve respektive. Ndërkohë që nga analiza e pasqyrave financiare të audituara për vitet 2021-2022, për arsye se vlera e investimeve të hyra në operim dhe të kapitalizuara ka qënë më e lartë se ajo e parashikuar, baza e rregulluar e asetëve të shoqërisë ka arritur në vlerën rreth 50 miliard lekë. Rritja e Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) lidhet kryesisht me realizimin dhe kapitalizimin e investimeve në proces të periudhave të mëparshme rregullatore.

Në nenin 8 pika 4 të Metodologjisë së përlllogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, përcaktohet ndër të tjera se ERE do të rishikojë investimet e realizuara kundrejt atyre të planifikuara/miratuara çdo fundviti.

Në zbatim të sa më sipër, për përlllogaritjen e Bazës së Rregulluar të Aseteve janë marrë në konsideratë investimet e realizuara dhe të kontabilizuara sipas pasqyrës së Aktiveve Afatgjata Materiale të pasqyrave financiare të audituara të periudhave 2021-2024. Për sa i përket viteve 2025 dhe 2026, ku të dhënat janë ende paraprake dhe në terma parashikimi, në vlerësimin e kryer janë konsideruar investimet e parashikuara në planin e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën 2023 – 2027, për të cilin ERE me vendimin e bordit nr. 308, datë 21.11.2025, ka filluar procedurën për shqyrtimin e tij si dhe dokumentacionit të përcjellë nga OSSH me anë të shkresës nr. 12802/1 prot., datë 24.02.2026, protokolluar në ERE me nr. 580/2 prot., datë 25.02.2026. Vlera e investimeve e konsideruar në këtë vlerësim për secilin vit respektiv paraqitet në tabelën në vijim:

Zëri	REALIZIMI 2021-2025			2025 paraprak	2026 paraprak
	2022 fakt	2023 fakt	2024 fakt		
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2021	15,761,590	15,761,590	15,761,590	15,761,590	15,761,590
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2022	8,026,629	8,026,629	8,026,629	8,026,629	8,026,629
Vlera e asetëve ne v. 2023		7,132,932	7,132,932	7,132,932	7,132,932
Vlera e asetëve ne v. 2024			3,197,273	3,197,273	3,197,273
Vlera e asetëve e parashikuara v. 2025				5,974,566	11,949,133
Vlera e asetëve e parashikuara v. 2026 (1/2)					4,533,549

Amortizimi

Në zbatim të përcaktimeve të metodologjisë, për efekt të kryerjes së këtij vlerësimi vlerat e amortizimit për periudhën 2022-2024 janë pranuar sipas evidencave të pasqyrës së aktiveve afatgjata të pasqyrave financiare të audituara për periudhën respektive, sipas sistemit fiskal për qëllime të rregullimit dhe përlllogaritjes së bazës së rregulluar të asetëve sikurse përcaktuar në pikën 7 të nenit 8 në Metodologjinë e përlllogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

Në tabelën në vijim paraqiten vlerat e amortizimit sipas realizimit faktik për periudhat 2022-2024 si dhe parashikimin për periudhat 2025-2026:

Zëri	REALIZIMI 2021-2025			2025 paraprak	2026 paraprak
	2022 fakt	2023 fakt	2024 fakt		
Amortizimi i vitit	3,997,638	4,170,309	4,329,438	4,427,987	4,234,746

Duke qenë se për 2025 – 2026 vlerat e marra në konsideratë janë kostot e parashikuara, në përputhje me parimet e metodologjisë këto zëra do të jenë objekt rishikimi në periudhat e ardhshme sipas vlerave faktike bazuar në pasqyrat financiare të audituara.

Sikurse vërehet në tabelën e mësipërme, për vitet 2025-2026 amortizimi i parashikuara nga OSSH sh.a. paraqitet po në të njëjtat nivele me vlerat e realizuara sipas sistemit fiskal mbështetur në pasqyrat financiare të audituara për periudhën 2022-2024.

Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit (WACC)

Në kuadër të rivlerësimit të kryer janë përdorur parametrat financiarë të miratuar në aplikimin e fundit të disponueshëm, dhe pranimeve të ERE sa i takon periudhës 2022 - 2023. Në këtë kontekst, norma e kostos së borxhit (CoD) dhe kthimi mbi kapitalin e vet (ARoE) janë konsideruar në të njëjtat nivele, e për rrjedhojë kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit mbetet në nivelin 7.81%, e cila do të jete objekt rishikimi në periudhat pasardhese mbështetur në përcaktimet e Metodologjisë së përlllogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

Të ardhurat e zbritshme

Të ardhurat e zbritshme janë vlerësuar sipas realizimit nga pasqyrat financiare të shoqërisë për periudhën 2022-2024, si dhe të ardhurat e pritshme për vitet 2025-2026, si më poshtë

Zëri	REALIZIMI 2021-2025			2025 paraprak	2026 paraprak
	2022 fakt	2023 fakt	2024 fakt		
Të ardhura nga lidhjet e reja	- 854,166	- 734,387	- 957,920	- 728,918	- 805,352
Të ardhurat nga energjia reaktive	- 564,128	- 505,419	- 456,267	- 634,381	- 530,538
Te ardhura nga Sherbime fikse te tarifuar per konsumin "0 kWh"	- 656,368	- 680,692	- 681,969	- 682,074	- 676,715
Te ardhura demi ekonomik	- 368,723	- 163,742	- 92,251	- 129,621	- 129,621

Konform “Metodologjisë së përlllogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017, duke marrë në konsideratë të gjithë komponentët e kostove dhe të ardhurave është përlllogaritur vlera e të ardhurave të kërkuara të realizuara për secilin vit të periudhës së marrë në shqyrtim ndaj sasive të lëvruara dhe atyre të parashikuara të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes. Në tabelën në vijim paraqesim tarifën mesatare të realizuar për periudhat e mbyllura ushtrimore dhe atë të pritshme për vitin 2026:

Zëri	REALIZIMI 2021-2025				2025 paraprak	2026 paraprak
	2021 fakt	2022 fakt	2023 fakt	2024 fakt		
Total OPEX	18,233,019	23,201,139	23,409,802	25,121,726	25,501,529	25,982,060
Fitimi	3,627,594	3,974,497	4,207,328	4,130,017	4,253,326	4,746,601
Amortizimi i vitit	3,717,228	3,997,638	4,170,309	4,329,438	4,427,987	4,234,746
Të ardhura nga lidhjet e reja	- 728,918	- 854,166	- 734,387	- 957,920	- 728,918	- 805,352
Të ardhurat nga energjia reaktive	- 402,747	- 564,128	- 505,419	- 456,267	- 634,381	- 530,538
Korrigjim i te Ardhurave tarifa mesatare realizuar ndaj asaj ne fuqi 2015-2021		3,106,826	3,106,826			
Te ardhura nga Sherbime fikse te tarifuar per konsumin "0 kWh"	- 637,821	- 656,368	- 680,692	- 681,969	- 682,074	- 676,715
Te ardhura demi ekonomik	- 347,775	- 368,723	- 163,742	- 92,251	- 129,621	- 129,621
Korrigjim i te Ardhurave tarifa mesatare realizuar ndaj asaj ne fuqi 2022-2026		-	668,144	1,914,586	3,094,690	4,454,512
Te ardhura te korigjueshme per periudhen 1 Janar-30 Prill 2022		1,588,953				
Të ardhura të tepërta të mbledhura (shuma e mbi-shlyerjes).						737,560
Totali i të Ardhurave të Kërkuara	23,460,580	33,425,668	33,478,169	33,307,360	35,102,538	36,538,134
Energji e lëvruar në rrjetin e shpërndarjes MWH	5,551,250	5,561,549	5,616,296	5,947,376	6,033,076	6,284,043
Tarifa mesatare e shpërndarjes Lekë/KWh	4.23	6.01	5.96	5.60	5.82	5.81

Në zbatim të Metodologjisë në fuqi, janë kryer dhe korrigjimet përkatëse midis tarifës mesatare të shpërndarjes së realizuara ndaj asaj të miratuar dhe rezultuese sipas secilit vit ushtrimor sikurse cituar dhe më lart, të cilat janë evidentohen në tabelën në vijim:

Zëri	2022 fakt	2023 fakt	2024 fakt	2025 paraprak
Totali i të Ardhurave të Kërkuara	33,425,668	33,478,169	33,307,360	35,102,538
Energji e lëvruar nërjetin e shpërndarjes MWh	5,561,549	5,616,296	5,947,376	6,033,076
Tarifa mesatare e shpërndarjes Lekë/KWh	6.01	5.96	5.60	5.82
Tarifa mesatare e shpërndarjes në fuqi Lekë/KWh	5.89	5.62	5.08	5.08
Diferenca e realizuar (mbi/nen) tarifën në fuqi Lekë/KWh	0.12	0.34	0.52	0.74
Diferenca e Korigjueshme e të Ardhurave të kërkuara (000/lekë)	668,144	1,914,586	3,094,690	4,454,512

Referuar të dhënave të certifikuara të pasqyrave financiare për vitet 2022-2024, duke marrë në konsideratë zërin e të ardhurave të realizuara nga faturimi i tarifave të shpërndarjes për secilin nivel tensioni në total si dhe parashikimin e vitit 2025, është kryer krahasimi me të ardhurat të kërkuara faktike dhe të parashikuara (të pasqyruara në tabelën si më poshtë).

Përshkrimi	2022 fakt	2023 fakt	2024 fakt	2025 paraprak	Total (2022-2025)
Të Ardhurat Faktike të faturuara nga Tarifat e Shpërndarjes për nivele tensioni në fuqi	30,054,688	32,956,289	35,617,584	37,422,734	136,051,295
Totali i të Ardhurave të Kërkuara të Realizuara	33,425,668	33,478,169	33,307,360	35,102,538	135,313,735
Diferenca e të ardhurave të mbledhura mbi/nën ato të lejuara nga aplikimi i tarifave për nivele tensioni në fuqi	3,370,980	521,880	- 2,310,224	- 2,320,196	- 737,560

Bazuar në diferencat rezultuese për ndërmjet të ardhurave të kërkuara faktike dhe të ardhurave të realizuara nga tarifave të shpërndarjes për secilin nivel tensioni në total sipas pasqyrave financiare të audituara për periudhën 2022-2024 dhe pasqyrave paraprake të vitit 2025, evidentohet një diferencë të ardhurash të realizuara tepër prej rreth 736 milion lekë të cilat janë konsideruar në zbritje të të ardhurave të kërkuara të parashikuara për vitin 2026.

Mbështetur në rregullat e pergjithshme dhe parimet bazë rregullatore të Metodologjisë në fuqi, janë konsideruar në përlllogaritjen e të ardhurave të kërkuara të parashikuara për vitin 2026 diferencat e korigjueshme sipas tabelave të mësipërme.

Si rezultat i të gjithë elementëve të mësipërm të cilët kanë shërbyer për përlllogaritjen e të ardhurave të kërkuara të parashikuara për vitin 2026, vlerësohet se tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për 2026 është në nivelin 5.81 lekë/kWh. Të ardhurat që do të realizohen nga diferenca prej 0.08 lekë/kWh vlerësohen ti lihen shoqërisë, me qëllim garantimin e likuiditetit të saj financiar si dhe uljen e ekspozimit të saj ndaj rrisqeve të mundshme për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara (në kushtet kur elementët ekonomik dhe teknik të marrë në konsideratë për qëllime të këtij vlerësimi sa i takon periudhës 2025-2026 janë njohur sipas parashikimeve të shoqërisë) duke garantuar kështu vijimin e aktivitetit të saj ushtrimor, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Në vijim paraqesim tabelën në të cilën evidentohen të gjithë komponentët e të ardhurave të kërkuara të realizuara dhe atyre të pritshme të konsideruara për qëllime të këtij vlerësimi:

Zëri	Vlersimi ERE	REALIZIMI 2021-2025			2025 paraprak	2026 paraprak
	2022 PARASHIKIM	2022 fakt	2023 fakt	2024 fakt		
Shpenzime Operative	9,072,104	8,471,122	8,768,165	10,565,574	10,606,661	11,601,113
Shpenzime materiale dhe konsumi	304,674	524,478	512,162	591,788	289,938	277,029
Shpenzime per personelin	5,043,102	4,838,595	5,616,688	6,512,499	7,090,354	7,232,132
Mirembajtje	1,442,000				1,313,090	1,235,855
Shpenzime kolaudim matësa	772,000					-
Marredhie me publikun dhe marketing	34,441				21,000	21,000
Qira	157,687	1,980	2,391	4,005	160,223	160,223
Sherbime postare dhe komunikimi	15,600	11,011	12,588	1,036	1,044	1,044
Shpensime teknologjia e informacionit	10,300				19,712	19,712
Shpenzime ligjore	1,030				9,634	9,634
Konsulenca dhe auditimi	85,250	14,520	7,470	49,734	64,686	64,686
Te tjera	1,206,020	3,080,538	2,616,866	3,406,512	1,636,980	2,579,798
Kosto e blerjes se energjise	15,152,136	14,730,017	14,641,637	14,556,152	14,894,868	14,380,947
Kosto e transmetimit për humbjet	753,293	794,774	744,155	884,530	938,409	938,409
Kosto e transmetimit për humbjet e njohur nga ERE për vitin 2015						
Kosto e transmetimit për humbjet mbi target sipas VKM 253						
Kosto e humbjeve Totale	14,286,900	13,635,377	13,732,330	13,530,865	13,800,137	13,259,894
Kosto për humbjet e njohur nga ERE për vitin 2015						
Kosto për humbjet mbi target sipas VKM 253 (ndrzhuar VKM nr.758/2021)						
Disbalanca	111,944	299,866	165,152	140,757	156,322	182,644
Total OPEX	24,224,240	23,201,139	23,409,802	25,121,726	25,501,529	25,982,060
Vlera E ASETEVE GIJTHSEJ v. 2014	32,042,520	32,042,520	32,042,520	32,042,520	32,042,520	32,042,520
Vlera e investimeve ne v. 2015	1,438,460	1,438,460	1,438,460	1,438,460	1,438,460	1,438,460
Vlera e investimeve ne v. 2016	6,995,748	6,995,748	6,995,748	6,995,748	6,995,748	6,995,748
Vlera e investimeve ne v. 2017	8,497,532	8,497,532	8,497,532	8,497,532	8,497,532	8,497,532
Vlera e investimeve ne v. 2018	6,761,186	6,761,186	6,761,186	6,761,186	6,761,186	6,761,186
Vlera e investimeve e miratuar per v. 2019	5,322,648	5,322,648	5,322,648	5,322,648	5,322,648	5,322,648
Vlera e asetëve ne v. 2020	1,690,628	5,754,721	5,754,721	5,754,721	5,754,721	5,754,721
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2021	7,471,381	15,761,590	15,761,590	15,761,590	15,761,590	15,761,590
Vlera e investimeve qe priten ne v. 2022	2,353,484	8,026,629	8,026,629	8,026,629	8,026,629	8,026,629
Vlera e asetëve ne v. 2023			7,132,932	7,132,932	7,132,932	7,132,932
Vlera e asetëve ne v. 2024				3,197,273	3,197,273	3,197,273
Vlera e asetëve e parashikuara v. 2025					5,974,566	11,949,133
Vlera e asetëve e parashikuara v. 2026						4,533,549
Vlera e asetëve Gjithsej	72,573,587	90,601,034	97,733,966	100,931,239	106,905,805	117,413,921
minus:Amortizimi i akumuluar	- 41,188,061	- 41,664,953	- 45,835,262	- 50,164,700	- 54,592,687	- 58,827,433
vlera e RAB pa përfshirë kapitalin e punës	31,385,526	48,936,081	51,898,704	50,766,539	52,313,118	58,586,487
Kapitali i punës	2,018,687	1,933,428	1,950,817	2,093,477	2,125,127	2,165,172
RAB	33,404,212	50,869,509	53,849,521	52,860,016	54,438,246	60,751,659
Norma e interesit të borxhit të vjetër	0.85%	0.85%	0.85%	0.85%	0.85%	0.85%
Norma e interesit të borxhit të ri	3.35%	3.35%	3.35%	3.35%	3.35%	3.35%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	16.44%	16.44%	16.44%	16.44%	16.44%	16.44%
Borxhi i vjetër %	30.95%	30.95%	30.95%	30.95%	30.95%	30.95%
Borxhi i ri %	29.05%	29.05%	29.05%	29.05%	29.05%	29.05%
Raport i synuar i kapitalit të vet	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%	40.00%
Kthim për borxhin e vjetër	0.26%	0.26%	0.26%	0.26%	0.26%	0.26%
Kthim për borxhin e ri	0.97%	0.97%	0.97%	0.97%	0.97%	0.97%
Kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet	6.58%	6.58%	6.58%	6.58%	6.58%	6.58%
WACC	7.81%	7.81%	7.81%	7.81%	7.81%	7.81%
Fitimi	2,609,912	3,974,497	4,207,328	4,130,017	4,253,326	4,746,601
Amortizimi i vitit	4,371,352	3,997,638	4,170,309	4,329,438	4,427,987	4,234,746
Të ardhura nga lidhjet e reja	- 532,075	- 854,166	- 734,387	- 957,920	- 728,918	- 805,352
Të ardhurat nga energjia reaktive	420,560	564,128	505,419	456,267	634,381	530,538
Korrigjimi i te Ardhurave tarifa mesatore realizuar ndaj asaj ne fuqi 2015-2021	3,090,005	3,106,826	3,106,826			
Te ardhura nga Sherbime fikse te tarifuar per konsumin "0 kWh"	- 639,804	- 656,368	- 680,692	- 681,969	- 682,074	- 676,715
Te ardhura demti ekonomik	- 270,464	- 368,723	- 163,742	- 92,251	- 129,621	- 129,621
Korrigjimi i te Ardhurave tarifa mesatore realizuar ndaj asaj ne fuqi 2022-2026		-	668,144	1,914,586	3,094,690	4,454,512
Te ardhura te korrigjueshme per periudhen 1 Janar-30 Prill 2022	1,588,953	1,588,953				
Të ardhura të tepërta të mbledhura (shuma e mbi-shlyerjes).						737,560
Totali i të Ardhurave të Kërkuara	34,021,559	33,425,668	33,478,169	33,307,360	35,102,538	36,538,134
Energji e lëvruar nërjetin e shpërndarjes MWH	5,775,730	5,561,549	5,616,296	5,947,376	6,033,076	6,284,043
Tarifë mesatare e shpërndarjes Lekë/KWh	5.89	6.01	5.96	5.60	5.82	5.81

Ne perfundim analizës së komponentëve të të ardhurave të kërkuara të parashikuara për vitin 2026 sa më sipër (të ardhurat e kërkuara faktike të shoqërisë OSSH sh.a. për periudhën 2022-2024 dhe atyre të parashikuara për periudhën 2025-2026), në mbështetje të parimeve të vendosjes së tarifave në zbatim të Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar si dhe “Metodologjisë

e llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017, vlerësojmë se:

- Vijimësia dhe siguria e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike përbëjnë një element thelbësor dhe me rëndësi kritike për garantimin e furnizimit të pandërprerë dhe cilësor të perdoruesve të rrjetit, si dhe për funksionimin e qendrueshëm të sistemit elektroenergjetik në tërësi. Kostoja e ndërprerjes së energjisë elektrike vlerësohet të jetë më e lartë se çdo komponent tjetër kostoje përgjatë zinxhirit të furnizimit me energji elektrike, duke theksuar nevojën për minimizimin e ndërprerjeve dhe garantimin e cilësisë së shërbimit dhe përballimin e kostove për ushtrimin e aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike sidomos në kushtet kur përdorimi i energjisë elektrike është një shërbim universal
- Referuar realizimit faktik të zërave, të cilët janë komponentë përlllogaritës të tarifës, rezulton se nga aplikimi i tarifave të shpërndarjes për nivel tensioni në fuqi, shoqëria gjeneron të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar kostot operative dhe për të siguruar vijueshmërinë e aktivitetit të saj operativ.
- Nga sa konstatohet nga analiza e pasqyrave financiare të audituara shoqëria paraqet ende nevojë për përmirësimin e strukturës së kapitalit të vet, i cili aktualisht rezulton negativ, duke krijuar risqe të mundshme në aspektin e qëndrueshmërisë financiare në terma afatmesme.
- Diferenca ndërmjet të ardhurave të kërkuara të korrigjuara dhe të ardhurave të realizuara rezulton relativisht e vogël, duke treguar një nivel të pranueshëm për periudhën e marrë në shqyrtim.
- Parametrat financiarë (WACC) janë mbajtur në nivelet e mëparshme për shkak të mungesës së informacionit të përditësuar, duke u konsideruar një trajtim i përkohshëm i cili do të mund të rishikohet mbështetur në përcaktimet legjislativë në fuqi në kohën e shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes për nivele tensioni në periudhën pasardhëse rregullatore.
- Duke marrë në konsideratë të ardhurat e kërkuara të korrigjuara dhe energjinë e parashikuar për tu shpërndarë, tarifa mesatare e shpërndarjes së energjisë elektrike e përlllogaritur për vitin 2026 bazuar në analizën e mësipërme, mbetet 5.89 lekë/kWh, mbi bazën e të ciles janë përlllogaritur dhe tarifat në fuqi të shërbimit të shpërndarjes për nivele tensioni si vijon:
 - Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV - 1.55 Lekë/kWh;
 - Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.6 - 20 kV - 3.99 Lekë/kWh;
 - Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV - 6.42 Lekë/kWh .

Çmimi i aplikueshëm i faturimit të energjisë reaktive, bazuar në përlllogaritjen e kostove të shkaktuara nga energjia reaktive në rrjetin e shpërndarjes është ai prej 1.92 lekë/kVArh për vitin 2022 sipas Vendimit nr.73/2022. Duke qenë se të dhënat e përditësuara për periudhat në vijim lidhen me paraqitjen e një aplikimi nga shoqëria, vlerësohet të vijojë të mbetet në fuqi i njeiti cmim.

Duke qenë se pasqyrat financiare të vitit 2025 janë paraprake, si dhe parashikimet që shoqëria OSSH sh.a. ka përcjellë për vitin 2026, janë të mbështetura mbi të dhënat paraprake të vitit paraardhës, në përputhje me parashikimet e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017, rezervojmë të drejtën për rishikimin e plotë të shpenzimeve operative (OPEX) dhe kapitale (CAPEX), duke u bazuar në realizimin faktik të zërave përbërës të këtyre kategorive të shpenzimeve me qëllim kryerjen e vlerësimeve dhe analizave për parashikimet e komponentëve të të ardhurave të kërkuara për periudhat e ardhshme rregullatore.

Për sa më sipër, vlerësojmë të nevojshme që tarifat e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për çdo nivel tensioni të mbeten të pandryshuara deri më 31.12.2026.

Në vijim të analizës së kryer dhe në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, vlerësojmë të nevojshme gjithashtu që shoqëria OSSH sh.a. të ndërmarrë masat për përmirësimin e cilësisë dhe detajimit të informacionit të paraqitur për qëllime rregullatore. Në këtë kuadër, OSSH sh.a. duhet të sigurojë ndarjen e plotë të kostove dhe të ardhurave sipas niveleve të tensionit, si dhe harmonizimin e raportimit financiar me kërkesat e raportimit Rregullator në përputhje me “Sistemin e njehësuar dhe të standardizuar të llogarive për të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike” miratuar me vendimin nr. 244/2018 të bordit të ERE për periudhat e mbyllura ushtrimore objekt i këtij vlersimi por dhe atyre të ardhshme.

OSSH duhet të paraqesë në formë të detajuar kostot operative dhe kapitale, të shoqëruara me shpjegime për luhatjet ndër-vjetore, si dhe e një informacioni të strukturuar mbi investimet e realizuara dhe të planifikuara, në përputhje me parimet e eficiencës dhe transparencës.

Në të njëjtën kohë, OSSH sh.a. duhet të paraqesë një analizë të përditësuar të parametrave financiarë, përfshirë koston e kapitalit (WACC), sipas kërkesave të Metodologjisë përkatëse.

Në përfundim, me qëllim kryerjen e vlersimeve të drejta mbështetur në parimet rregullatore sipas legjislacionit në fuqi, bëhet e nevojshme që shoqëria të depozitojë në ERE pasqyrat financiare të audituara të vitit 2025 si dhe aplikimin për përcaktimin e tarifave të shërbimit të Shpërndarjes së energjisë elektrike për Nivele Tensionit në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Në mbështetje të neneve 16, 19, 20, germa c) të Ligjit nr. 43/2015 ‘Për sektorin e energjisë elektrike’, i ndryshuar; VKM nr. 456 datë 29.06.2022, ‘Për miratimin e kushteve për vendosjen

e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarce në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike’, e ndryshuar, neneve 15 dhe 19, pika 1, germa c) të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE-s; “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017, i propozojmë Bordit të ERE-s:

- 1. Përcaktimin e tarifave të përkohshme të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit, për periudhën 1 Maj – 31 Dhjetor 2026, si vijon:**
 - Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV - 1.55 Lekë/Kwh;
 - Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.6 - 20 kV - 3.99 Lekë/Kwh;
 - Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV - 6.42 Lekë/Kwh.
- 2. Përcaktimin e cmimi i aplikueshëm për faturimin e energjisë reaktive për periudhën 1 Maj – 31 Dhjetor 2026 prej 1.92 lekë/kVArh**
- 3. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërisë OSSH sh.a., do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 20, germa c) të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe metodologjisë përkatëse të miratuar nga Bordi i ERE-s.**